

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

**Pkl. – Kzz. Nr. 97/2010**

**1 shkurt 2011**

**Prishtinë**

**NË EMËR TË POPULLIT**


Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Lars Dahlstedt si Kryetar i Kolegjit dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Emine Mustafa dhe Marije Ademi si anëtare të kolegjit.

Të ndihmuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Sampsa Hakala si procesmbajtës,

Në procedurën penale kundër A. [REDAKTUAR] M. [REDAKTUAR] Shqiptar i Kosovës, i lindur [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] emri i babait [REDAKTUAR], emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës [REDAKTUAR] vendi i lindjes fshati [REDAKTUAR] Komuna Istog, me banim në të njëjtin vend, Numri i letërnjoftimit [REDAKTUAR] i martuar, profesioni [REDAKTUAR]

Të dënuar me anë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë në lëndën AP.nr. 93/2010, të datës 7 shtator 2010 për vepër penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në kundërshtim të Nenit 339 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burg.

Duke vendosur pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 19 tetor 2010, nga Avokatët mbrojtës O. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] dhe F. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] në emër të të pandehurit kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Klinë P.nr. 36/2010, të datës 25 mars 2010, dhe atij të Gjykatës së Qarkut në Pejë AP.nr. 93/2010, të datës 7 shtator 2010.



Pas leximit të mendimit dhe propozimit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës të parashtruar më 8 dhjetor 2010 nga Prokurorja e Shtetit Laura Pula dhe pas këshillimit dhe votimit të Kolegjit të Gjykatës Supreme të mbajtur më 1 shkurt 2011.

Duke vepruar në përputhje me Nenet 454 dhe 456-457 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) lëshon këtë

### **AKTGJYKIM**

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur më 19 tetor 2010, nga i pandehuri A. M. përmes Avokatëve të tij mbrojtës kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Klinë P.nr. 36/2010, të datës 25 mars 2010, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ap.nr. 93/2010, të datës 7 shtator 2010, PRANOHET PJESËRISHT.**

**Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ap.nr. 93/2010, ndryshohet si në vijim:**

**Duke u bazuar në Nenin 73 paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenet 278 paragrafin 7 dhe 391 paragrafin 5 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak do të llogaritet në dënimin me burg.**

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në pjesët e mbetura REFUZOHET si e pabazuar.**



## ARSYETIMI

### I Historia e Procedurës

Më 1 shkurt 2010 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) paraqiti aktakuzën (PPS.nr. 2/2010) përmes së cilës A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] u akuzua për veprat penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të Nenit 339 paragrafit 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së dhe Mashtrim, në kundërshtim të Nenit 261 paragrafit 1 të KPK-së.

Shqyrtimi gjyqësor kundër A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] u mbajt më 5 mars 2010 dhe 25 mars 2010 në Gjykatën Komunale në Klinë. Më 25 mars 2010 A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] u dënua me aktgjykimin (P.Nr. 36/2010) për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të Nenit 339 paragrafit 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së. A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] u dënua me burg në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj. Dënimi me burg u pezullua me kusht që i pandehuri të kompensojë dëmin e shkaktuar ndaj [REDAKTUAR] dhe N [REDAKTUAR] siç u përcaktua me anë të aktgjykimit të njëjtë në shumë prej 4.500,00 (katërmijë e pesëqind) Euro dhe 700,00 (shtatëqind) Franga Zvicerane. Koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak është llogaritur si pjesë e dënimit të shqiptuar.

Gjykata Komunale në Klinë e liroi A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] nga akuza për Mashtrim, në kundërshtim të Nenit 261 paragrafit 1 të KPK-së.

Aktgjykimi i lartpërmendur u ankimua nga dy Avokatët mbrojtës të të pandehurit dhe nga Prokurori Special. Duke vepruar sipas këtyre ankesave Gjykata e Qarkut në Pejë me aktgjykimin (AP.Nr. 93/2010), të datës 7 shtator 2010 refuzoi ankesat e mbrojtjes dhe pjesërisht pranoi ankesën e Prokurorit Special. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale u Kline [REDAKTUAR] u ndryshua s ai përket dënimit dhe A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] u dënua për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të Nenit 339 paragrafit 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së lidhur me paragrafin 1 me një (1) vit e gjashtë (6) muaj



burg pa e pezulluar dënimin. Aktgjykimi i shkallës së parë u vërtetua sa i përket lirimit të A. M. për veprën penale të Mashtrimit, në kundërshtim të Nenit 261 paragrafit 1 të KPK-së.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë iu dorëzua të pandehurit më 2 tetor 2010.

Më 19 tetor 2010 Avokatët mbrojtës O. B. dhe F. C. paraqitën kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të të pandehurit A. M. kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Klinë (P.nr. 36/2010), dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë (AP.nr. 93/2010).

Më 8 dhjetor 2010 ZPSHK-ja paraqiti një përgjigje ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Më 12 dhjetor 2010 Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it vendosi (JC/EJU/OPEJ/2146/mgc/10) që kolegji i Gjykatës Supreme të përbëhej prej një Gjyqtari të EULEX-it si kryetar dhe dy Gjyqtarëve Kosovarë si anëtarë të kolegjit.

### **I Çështjet e ngritura në Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë dhe përgjigja e prokurorisë**

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtja pretendon shkeljet vijuese të rregullave të procedurës penale dhe një shkelje të ligjit penal:

- Neni 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK-së është shkelur nga të dyja instancat sepse dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimeve.
- Ligji penal është shkelur nga të dyja instancat sepse i pandehuri është dënuar për veprën penale të përcaktuar me Nenin 339 paragrafët 1 dhe 2 edhe pse nuk ishte atë dispozitë të



kodit penal. I pandehuri madje kurrë nuk është akuzuar për qëllim të shkaktimit të dëmit.

- Neni 403 paragrafi 2 i KPPK-së në lidhje me nenin 415 të KPPK-së është shkelur nga Gjykata e Qarkut në Pejë sepse gjykata e shkallës së dytë ka tejkualuar shqyrtimin e ankesës duke e ri-cilësuar veprën penale në dëm të të pandehurit.
- Ligji është shkelur sepse koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak nuk është përfshirë në dënimin e shqiptuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë. Periudha e saktë e llogaritur nga Gjykata Komonale në Klinë, nuk është specifikuar në mënyrë adekuate.
- Ligji penal është shkelur nga të dy instancat sepse i pandehuri është dënuar për një vepër penale të cilën nuk e ka kryer.

Mbrojtja e A. M. propozon që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe lënda të kthehet në shkallën e parë për rigjykim ose, si alternativë, të lirohet i pandehuri ose së paku t'i zbutet dënimi duke i shqiptuar një dënim me kusht.

Prokurorja e Shtetit me mendimin dhe propozimin e saj propozon që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Prokuroria konstaton se dispozitivi është i kuptueshëm dhe përshkruan faktet vendimtare dhe veprimet inkriminuese të të pandehurit. Dispozitivi ofron arsye të mjaftueshme pa asnjë kontradiktë mbi gjetjet faktike dhe ligjore. Dënimi ka qenë i duhur.

### III Gjetjet e Gjykatës Supreme

#### A. Kompetencat e Gjykatës Supreme dhe pranueshmëria e kërkesës

Sipas nenit 454 dhe nenit 26 paragrafit 3 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka kompetenca për të gjykuar lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Kolegji është formuar në përputhje me nenin 3.7 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.



Gjykata Supreme gjen se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur nga personat e autorizuar brenda afatit kohor.

Gjykata Supreme tani do ta analizojë dhe vlerësojë secilën çështje të ngritur në kërkesë nga mbrojtja.


*B. A është cilësuar në mënyrë të drejtë vepra penale për të cilën akuzohet A [redacted] M [redacted] sipas nenit 339 paragrafit 2 të KPK-së?*

Mbrojtja e A [redacted] M [redacted] ka pretenduar se Gjykata Komunale në Klinë dhe Gjykata e Qarkut në Pejë nuk e kanë aplikuar nenin 339 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së në mënyrë të drejtë. Kjo përbën shkelje të procedurës penale (duke krijuar kundërthënie në mes të dispozitivit dhe pjesës së arsytimit) si dhe shkelje të ligjit penal (qëllimi specifik për të shkaktuar dëm nuk është vërtetuar siç kërkohet).

Shkeljet e pretenduara të procedurës penale dhe ligjit penal do të vlerësohen në të njëjtën kohë, pasi që të dyja janë të lidhura me të njëjtën pyetje: si do të duhej të aplikohet neni 339 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së në gjendjen e vërtetuar faktike në këtë lëndë?

Gjykata e Qarkut në Pejë me aktgjykimin AP.Nr. 93/2010 ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm sa i përket dënimit, kurse gjendja faktike është konsideruar si e vërtetuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë (faqe 7 e aktgjykimit në versionin në gjuhën angleze). Përshkrimi i veprës penale për të cilën A [redacted] M [redacted] është dënuar mund të gjenden në aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Klinë P.Nr. 36/2010 (faqet 1 dhe 2 të versionit në gjuhën angleze):

*"I pandehuri shpallet fajtor për veprën Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së sepse në cilësinë e tij si polic hetues në vrasjen e V [redacted] M [redacted] në vitin 2006, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore; ai ka*




shpërdorur pozitën e tij zyrtare – gjatë muajve shkurt ose mars 2008 ai ka shkuar në shtëpinë e N. T. babai i të ndjerit, në Pogragjë dhe në prani të T. ai i ka kërkuar shumën prej 10.000 Euro për ta zbuluar autorin e vrasjes së V. T. me arsyetimin se ai duhej ta paguante burimin e informimit. Pra, ai ka vepruar në këtë mënyrë edhe pse e ka ditur se ai mund ta paguante informatorin nga buxheti i caktuar i Policisë së Kosovës. Në këtë mënyrë, ai ka pranuar shumën prej 4.500,00 Euro dhe 700 Franga Zvicerane nga dhe në tri raste të ndara.”

2. N.T.

Mbrojtja e A. M. ka insistuar gjatë gjithë procedurës penale se edhe po të dëshmohej vepra penale për të cilën akuzohet, i pandehuri nuk do të mund të dënohej sipas formës së cilësimit të veprës penale sipas nenit 339 paragrafit 2 të KPK-së, sepse i pandehuri nuk ka pasur për qëllim që të shkaktoj dëm. Mbrojtja në veçanti i referohet formulimit të nenit 339 paragrafit 2: “Nëse vepra penale ... rezulton në dëm i cili e tejkalon shumën 2.500 Euro...” kurse A. M. është akuzuar dhe dënuar për shpërdorim të pozitës së tij zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore (në shumë 4.500 euro dhe 700 Franga Zvicerane). Prandaj, akuza ka mundur ta plotësoj vetëm kriterin e Shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit në formën e saj bazike (neni 339 paragrafi 1) e cila është e dënueshme me burgim deri në një vit.

Gjykata Supreme gjen se arsyet e lartpërmendura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara. Vepra penale është cilësuar në mënyrë të drejtë sipas nenit 339 paragrafit 2, dhe arsyetimi në mbështetje të gjetjeve ligjore në të dy aktgjykimet e kundërshtuara është në bashkëpunim të mjaftueshëm me përmbajtjen e dispozitivit të këtyre aktgjykimëve.

I pandehuri është dënuar për shkak të shpërdorimit të pozitës së tij zyrtare me qëllim të drejtpërdrejtë për të përfituar dobi pasurore (në shumë prej 4.500 Euro dhe 700 Franga Zvicerane). Cilësimi i veprës siç përcaktohet me nenin 339 paragrafin 2 të KPK-së është bazuar në faktin se vepra ka rezultuar në dëm i cili e tejkalon shumën 2.500 Euro.



Neni 339 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK, shkruajnë si në vijim:


*"Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit*

*(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit.*

*(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili tejkalon shumën 2.500 EUR apo me shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet."*

Si rregull udhëzuese se si të interpretohet ligji penal mbi të gjitha qëndron *Parimi i ligjshmërisë*: përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, ndiqet ose shpallet fajtor (neni 1 paragrafi 3 i KPK-së).

A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] ka kryer veprën penale duke kërkuar dhe pranuar pagesën e kundërligjshme përmes mashtrimit të palëve të dëmtuara siç është përshkruar më lart. Si pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre veprimeve palët e dëmtuara kanë vuajtur emocionalisht, të cilat i pandehuri është urdhëruar që t'i kompensojë. Me fjalë të tjera, t'i përmbahemi rregullit *conditio sine qua non*, një lidhje e rëndomtë ekziston në mes të veprës penale dhe lëndimit. Lëndimi nuk do të ishte shkaktuar pa vepër. Lidhja e rëndomtë është vërtetuar në mes të veprës dhe rezultatit sepse veprimet e A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshme kanë rezultuar në dëmin i cili tejkalon shumën 2.500 Euro. Nuk mbetet hapësirë për keqinterpretim: elementi objektiv (*actus reus*) i formës së cilësimit të shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit është përmbushur.





Sa i përket elementit subjektiv (*mens rea*) të veprës penale, Gjykata Supreme vëren se-përkundër asaj që pretendon mbrojtja - *dashja e për të shkaktuar dëm nuk është e nevojshme* në paragrafin e dytë të nenit 339 të KPK-së.

Në rrethana të përgjithshme, përgjegjësia penale përcjell vetëm veprimet e qëllimshme. Kjo rezulton nga Neni 11 paragrafi 3 i KPK-së i cili përcakton se një person ka përgjegjësi penale për që personi është përgjegjës penalisht për *kryerjen nga pakujdesia* të veprës penale *vetëm* nëse këtë shprehimisht e parashikon ligji.

Megjithatë, sa i përket të ashtuquajturës pasoja të rënda që rrjedhin nga kryerja e veprës penale kjo është e rregulluar me Nenin 17 të KPK-së ("Përgjegjësia për pasoja më të rënda") kur kryerja e veprës penale shkakton pasoja që tejkalon dashjen e kryerësit dhe kur ligji parasheh një dënim më të lartë, dënimi më i lartë mund të shqiptohet nëse pasoja i atribuohet *pakujdesisë* së kryerësit.

Gjykata Supreme gjen se Neni 17 i KPK-së vlen po ashtu edhe për formën e cilësuar të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit sipas Nenit 339 paragrafit 2 të KPK-së sipas të cilit një dënim më i rëndë do të shqiptohet kryerësit kur vepra penale e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni rezulton me dëm i cili tejkalon shumën 2.500 EUR. Vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të Nenit 339 të KPK-së mund të referohet si "formë themelore" e Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit. Qëllimi i drejtpërdrejtë e të pandehurit kërkohet për të kryer formën themelore të veprës penale kurse qëllimi për të shkaktuar dëmtim nuk kërkohet në mënyrë që të konstatohet i pandehuri penalisht përgjegjës për formën e cilësuar të kësaj vepre penale. Kjo ishte vërtetuar drejt nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë.

Për të dënuar të pandehurin në këtë lëndë duhet të përcaktohet vërtetohet që ai ka vepruar me pakujdesi sa përket pasojave (dëmit i cili tejkalon 2.500 EUR). Përveç kësaj, duhet të vërtetohet se i pandehuri ka qenë në dijeni të mundshme për të gjitha faktet relevante dhe rrethanat por prapë e ka kryer veprën penale. A [REDACTED] M [REDACTED] nuk mund të shpallet fajtor për krimin e kualifikuar të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit, nëse në



kohën e kryerjes së veprës penale ai nuk ka qenë i vetëdijshëm me tiparet e asaj vepre (neni 18 i KPK-së “Lajthimi faktik”).


Gjykata Supreme gjen se në mënyrë të duhur është vërtetuar nga të dy shkallët e mëparshme përtej dyshimit të bazuar që A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] ishte i vetëdijshëm për veprimet e tija. Ai me vetëdije kërkoi dhe pranoni shumën e të hollave (bile kërkoi më shumë ) siç është akuzuar dhe ishte i vetëdijshëm që kjo si pasojë do të rezultojë në humbje ekonomike për palët e dëmtuara. Ai pastaj me qëllim do të vazhdonte me kryerjen e veprës penale edhe pse ai ishte i vetëdijshëm për dëmet që do të shkaktonte si rezultat i kësaj. Gjykata Supreme përfundon që edhe pse i pandehuri nuk ka pasur qëllim të drejtpërdrejtë që ti shkaktojë dëme palëve të dëmtuara, ende ekziston vetëdija e tij rreth rrethanave cilësuese dhe pasojat e veprimeve të tija i atribuohet më së paku pakujdesisë së të pandehurit. Prandaj, vepra penale duhet të cilësohet sipas nenit 339 paragrafit 2 të KPK-së dhe argumentet e prezantuara nga mbrojtja në këtë pikë refuzohen si të pabazuara.

*C. Shkelja e pretenduar e nenit 403 paragrafit 2 në lidhje me nenin 415 të KPPK-së sepse gjykata e shkallës së dytë tejkaloi fushën e shqyrtimit ankimorë*

Mbrojtja pretendon në shkeljen e procedurës penale sepse Gjykata e Qarkut në Pejë ka ri-cilësuar veprën penale edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është kundërshtuar nga ankesa e Prokurorit Special në lidhje me kualifikimin e veprës.

Pas ekzaminimit të versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit (AP.nr.93/2010) të Gjykatës së Qarkut në Pejë që është nënshkruar nga anëtarët e kolegjit, Gjykata Supreme konstaton gjithashtu se kjo bazë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Fillimisht, duhet të vërehet që Gjykata e Qarkut në Pejë e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm lidhur me dënimin ndërsa asnjë ri-cilësim i veprës penale nuk është bërë. Nuk ekziston asnjë mospërputhje në mes të dy aktgjykimeve duke lënë anash dënimin.




Mbrojtja ka vënë në pah që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë do të mund ti referohej dispozitave tjera ligjore siç është bërë në aktvendimin (P.Nr. 36/2010) të Gjykatës Komunale në Klinë. Përsëri duke e shqyrtuar versionin në gjuhën angleze, aktgjykimi tregon që referencë e plotë i është bërë dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë në nenin 339 Paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së (faqe 1 të versionit në gjuhën angleze). Saktësisht dispozita të njëjta gjenden në aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Klinë (faqe 1 të versionit në gjuhën angleze). Sa i përket versionit në gjuhën angleze, i cili konsiderohet si version i mirëfilltë, nuk përfshin asnjë ri-cilësim aktual lidhur me emërtimin e veprës penale apo të dispozitave të referuara të kodit penal, asnjë shkelje të rregullave të procedurës penale nuk mund të vërtetohen. Ky konfuzion nga mbrojtja duket të jetë i shkaktuar nga disa mangësi në përkthimin shqip të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë (AP.nr.93/2010).

*D. Ligji është shkelur sepse koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nuk është përfshirë në dënimin e shqiptuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë*

Me aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut në Pejë (AP.nr.93/2010), përderisa është ndryshuar dënimi në dëm të të pandehurit, nuk është vendosur saktësisht për përfshirjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak. Llogaritja e heqjes së lirisë në dënimin me burgim është e obligueshme siç kërkohet nga neni 73 Paragrafit 1 të KPK-së dhe kjo duhet të përmendet në aktgjykim në pajtim me nenet 396 paragrafi 4 dhe nenit 391 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të KPPK-së.

Për shkak të këtij mosveprimi është vërtetuar shkelje e ligjit penal siç është parashikuar me nenin 404 paragrafi pika 6 e KPPK-së dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë (AP.nr.93/2010) do të ndryshohet në këtë aspekt në të mirë të pandehurit.

Sa i përket çështjes nëse periudha e saktë kohore e kaluar në paraburgim apo në arrest shtëpiak do të mund të ishin treguar në aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe




Gjykatës Komunale në Klinë, Gjykata Supreme gjen se llogaritja e saktë nuk kërkohet me ligj dhe se në këtë aspekt nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje.

*E. Shkelja e pretenduar e ligjit penal sepse A [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] është dënuar për veprën penale të cilën nuk e ka kryer*

Kjo pjesë e kërkesës në mënyrë të qartë vë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar nga aktgjykimet e kundërshtuara të Gjykatës Komunale në Klinë (P.Nr. 36/2010) dhe të Gjykatës së Qarkut në Pejë (AP.nr.93/2010). Gjykata Supreme gjen se në pajtim me nenin 451 paragrafit 2 të KPPK-së kërkesë e tillë për mbrojtje të ligjshmërisë, për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk mund të ushtrohet siç është dorëzuar nga mbrojtja në këtë rast.

Megjithatë, Gjykata Supreme do të vlerësoj nëse arsyetimi lidhur me faktet materiale ishin paraqitur në aktgjykimet e kontestuara sipas rregullave të procedurës penale. Dispozitat e procedurës penale përshkruajnë që gjykatat duhet të theksojnë qartë dhe shteruese se cilat fakte i konsideron të dëshmuara ose jo të dëshmuara, e gjithashtu edhe bazat për këtë. Gjykatat gjithashtu duhet në veçanti të bëjnë vlerësimin e besueshmërisë së provave kontradiktore. Sa i përket detyrave të gjykatës së shkallës së dytë, në pajtim me nenin 427 paragrafit 1 të KPPK-së, në arsyetimin për aktgjykimin e vet, gjykata e shkallës së dytë, duhet të vlerësoj deklaratat që janë subjekt i ankesës. Dështimi për të përmbushur kërkesat e këtyre dispozitave mund të rezultojë në shkeljen substanciale të dispozitave të procedurës penale nëse mosveprim i tillë nga gjykata ka ndikuar ose ka mundur të ndikoj në marrjen e aktgjykimin të ligjshëm dhe të drejtë.

Në lëndën në fjalë, Gjykata Supreme gjen se vlerësimi i provave është bërë nga gjykata e shkallës së parë (Gjykata Komunale në Klinë) në pajtim me kërkesat ligjore dhe në mënyrë të kujdesshme, transparente dhe bindëse. Të dyja pjesët fajësuese dhe shtajësuese të provave janë vlerësuar dhe asnjë provë materiale nuk është përjashtuar nga shqyrtimi gjyqësor. Gjykata në mënyrë të qartë ka theksuar se çka është konsideruar e dëshmuar



dhe cilat pretendime faktike kanë mbetur të padëshmuara. Sa i përket aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë si gjykatë e shkallës së dytë ka siguruar përgjigje në të gjitha pyetjet relevante të ngritura në ankesat e mbrojtjes. Kjo e shpien Gjykatën Supreme të përfundoj se asnjë shkelje e ligjit nuk është vërtetuar në këtë pjesë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

#### *F. Dënimi*

Sa i përket dënimit, Gjykata Supreme mbron se Gjykata e Qarkut në Pejë nuk e ka tejkaluar kompetencën e saj sipas ligjit (neni 38 dhe neni 339 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së dhe neni 404 pika 5 e KPPK-së ) duke shqiptuar dënimin e burgimit prej një (1) viti dhe gjashtë (6) muaj për të pandehurin. Dënimi ishte në pajtim me fushën e shqyrtimit ankimor pasi që ishte subjekt i ankesës së Prokurorit Special. Si përfundim, në këtë aspekt në aktgjykimin e kundërshtuar nuk mund të vërtetohet asnjë shkelje e Ligjit Penal.

#### **IV Përfundim**

Për shkak të arsyeve të lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv.

**1 shkurt 2011.**

**Pkl. – Kzz. Nr. 97/2010**

E përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar.

**Kryetar i kolegjit**

Lars Dahlstedt



**Anëtare e kolegjit**

**Emine Mustafa**

**Procesmbajtës**

**Sampsa Hakala**



**Anëtare e kolegjit**

**Marije Ademi**